



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË

Nr. 889 Prot

Lezhë, më 29.09.2023

L ë n d a: Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak të kandidatëve për procedurën e ngritje në detyrë, në kategorinë drejtuese, pozicionin “Shef/e Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë”;

KESHILLI I LARTË GJYQËSOR

Adresa: Godina “Poli i Drejtësisë”,
Rr. “Ana Komnena”
Tiranë

Bazuar në Ligjin Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”, vendimit Nr.622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, neni 9, udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, njoftimit nr.785 Prot, datë 07.09.2023, për shpalljen e procedurës së “*lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor*” në kategorinë drejtuese”, për pozicionin “Shef/e Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë”; “, kategoria III-2, ju njoftojmë:

Në përfundim të afatit (datë 28.09.2023), në lidhje me procedurën e ngritjes në detyrë, në kategorinë drejtuese, në pozicionin “Shef/e Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë ” është paraqitur **një aplikante** e cila pas verifikimit paraprak, rezulton që plotëson kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta dhe të përgjithshme si më poshtë;

1. Adelina Dedgjonaj

Në këto rrethana bazuar në nenin 17 e 19 të vendimit nr.622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për procesin e plotësimit të vendeve të lira nëpërmjet procedurës së “*lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor*”, procedura për ngritjen në detyrë do të vazhdojë me vlerësimin profesional që do të zhvillohet nga Këshilli i Gjykatës.

Për datën e mbledhjes do të njoftoheni në një moment të dytë, për shkak të ngarkesës së punës së trupës gjyqësore e cila është e përbere vetem nga dy gjyqtarë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

KANCELARE
Ardiana Krasniqi

